
TERMAT E REFERENCES

OBJEKTI: “CLOUD MAIL SERVER”

1.1. Specifikimet Teknike për Licensë Microsoft 365 Business Basic, Licensa duhet të ofrojë:

- Versione Web dhe mobile të: Word, Excel, PowerPoint, Outlook
- Chat, Telefonata dhe takime me Teams nga Laptop/Desktop, Tablet ose Telefon
- Aplikimet Microsoft 365 në web, të ofrojnë gjatë gjithë kohës Word, PowerPoint, OneNote dhe Outlook të azhornuara në web.
- Të ofrojë bashkëpunim të njëkohshëm me të gjithë, përmes web-it, pajisjeve mobile, dhe pajisjeve të ndryshme pa pasur nevojën të instalohen këto aplikime.
- Chat, Telefonata dhe takime me Microsoft Teams, të kombinuara në një aplikim.
- Site Intranet dhe Teams, të ofrojnë mundësinë që të informohen dhe angazhohen bashkëpunëtorët me ndërfaqet e grupit përmes SharePoint.
- Të organizohen oraret dhe manaxhohen takimet përmes një kalendari në web, i cili të integrohet me Outlook për t'u dhënë përdoruesve lehtësinë të caktojnë një orar që u përshtatet.
- Outlook me kapacitet të mailbox 50GB për përdorues.
- Mundësi për të dërguar dokumenta të bashkëngjitur deri në 150MB kapacitet.
- 1 TB hapësirë ruajtëse në OneDrive për të ruajtur dhe shpërndarë dokumentat në të gjitha pajisjet e përdoruesit.
- *Periudha e abonimit 1 vit, numri i përdoruesve 300.*

1.2. Zgjidhje Backup

- Të mundësojë backup të të dhënave Exchange, SharePoint, OneDrive.
- Të përcaktojë nivele të duhura të mbrojtjes për sete të ndryshme të të dhënave, duke vendosur politika të ndryshme me schedule të ndryshme.
- Të ketë mundësinë të kopjojë backup-et në një hapësirë ruajtëse dytësore të veçantë ose edhe nëpër re për të eliminuar varësinë e reve kompjuterike dhe për të rritur besueshmërinë.
- Të ofrojë mundësinë e rikuperimit të të dhënave saktësisht si kerkohen nga biznesi, qoftë në vendndodhjen ose përdoruesin e tij origjinal, ose në një vendndodhje ose përdorues tjetër.
- Të ofrojë mundësinë e rikuperimit aq sa nevojitet, pavarësisht nëse është për të gjithë përdoruesit e Microsoft 365, një përdorues, dosje ose skedar individual.
- Të ofrojë mundësinë e rikuperimit në kohë minimale kur rikuperohen shumë përdorues të Microsoft 365 në një veprim të vetëm.
- Të ofrojë mundësinë e rikuperimit me lehtësi të dokumenteve të Microsoft 365 në mënyrë që të plotësohen kërkesat rregullatore ose ligjore në kohën e duhur dhe me kosto efektive.
- Të ofrojë mundësinë e kërkimit global, të kërkohet në të gjithë përdoruesit në të njëjtën kohë për të gjetur me shpejtësi dhe pa mundim artikuj të veçantë të gjendur në grupe të mëdha të dhënash rezervë.
- Të ofrojë mundësinë e filtrave të kërkimit të gjerë, të gjejë shpejt të dhënat duke ngushtuar fushën e kërkimit me një listë të gjerë të filtrave të kërkimit dhe kombinimeve të filtrave.

- Të ofrojë mundësinë e vendosjes në ambiente, në një re në shkallë të lartë ose me një ofrues shërbimi - me arkitekturë që mund të mbështesë edhe ndërmarrjet më të mëdha.
- Të ofrojë mundësinë e zgjedhjes së infrastrukturës duke i ruajtur kopjet rezervë kudo qoftë në ambiente (në çdo pajisje) ose në cloud, në çdo platformë që zgjidhet.
- Të ofrojë mundësinë e fleksibilitetit të infrastrukturës për t'u përshtatur me ndryshimet në strategjitë e IT (përfshirë vendndodhjen e ruajtjes, llojin e hardware-it ose llojin e resë kompjuterike).
- *Periudha e abonimit 1 vit, numri i përdoruesve 300.*

1.3. Implementimi

Implementimi i Licensave Microsoft 365 dhe zgjedhjes Backup në Cloud.

- Licensat duhet të integrohen dhe aktivizohen në një tenant të vetëm në llogarinë e institucionit.
- Duhet të realizohet krijimi i përdoruesve në AD e krijuar në platformën cloud.
- Duhet të realizohet krijimi i mailboxeve përkatëse të secilit përdorues dhe shërbime të tjera të lidhura me të.
- Duhet të testohen komunikimet e llogarive e-mail në cloud e pas verifikimeve përkatëse të kryhet shkëputja nga Exchange On-Prem.
- Aktivizimi i Licensave të zgjedhjes së backup në cloud.
- Krijimi i ambientit të backup, lidhja e secilit user me këtë ambient.
- Të ndërtohen politikat e backup-it për përdoruesit.
- Testimi i backup dhe restore të të dhënave të përdoruesve.
- Dorëzimi i gjithë zgjedhjes.

1.4. Shërbime të mirëmbajtjes mujore.

Suporti i kërkuar për këto Software duhet të jetë për një periudhë 1 (nje) vjeçare respektivisht, me kohë përgjigje brenda ditës së nesërme të punës, mbulimi përgjatë orarit zyrtar (intervali 9:00- 17:00 nga e Hëna në të Premte), shërbimin e ofruar në distancë (lidhje remote) dhe në raste kritike, në ambientet e klientit, suporti dhe diagnostikimi në distancë, ndjekjen e problemit deri në zgjidhjen përfundimtare.

Shërbimet e ofruara duhet të kategorizohen në dy lloje:

a) **Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese**

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për Software-t e listuar mësipër. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen në distancë (lidhje remote).

b) **Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e APD)**

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, gjatë orarit 9:00 - 17:00, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i APD. Për këtë qëllim, me termin “Alarm Madhor” do të kuptohet parashtimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të mosfunksionimit të Softwareve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të proceseve të punës në APD.